

A K T
T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PRESF IN WORLD” SH.P.K.



Me ane te ketij dokumenti , te emertuar Akt-Themelimi, sot me date 23.10.2018

1. Z. STEFANO SANTI, i biri i Franco, i datelindjes 25.06.1953, lindur ne Rome dhe banues ne Rome, Rr.Giacomo, Trevis, Nr.76, SC.UN PI 3 IN.15, Itali , nenshtetas italian, i pajisur me Karte e Identitetit te Republikes se Italise nr. AY 8038168, leshuar me date 18.07.2018 dhe date skadimi 25.06.2029.

2. Z. PIERO TITO ARGIOLAS, i biri i Cesare, i datelindjes 04.12.1965, lindur ne Villasalto (CA) dhe banues ne Rr. Lega S. 10 Latina (LT), Itali, nenshtetas Italian, i pajisur me Karte e Identitetit te Republikes se Italise me nr.CA99012BQ, leshuar me date 02.07.2018 dhe date skadimi 04.12.2028.

3. Z.SHPETIM TROPLINI, i biri i Gani-ut, i datelindjes 26.07.1969, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagja 5, Rr.Andon Naci, Pall.636, nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e Republikes Italiane me nr.YA3856554, leshuar me date 12.05.2012 dhe date skadimi 11.05.2022.

4.Z.ARIAN DEDEJ, i biri i Besnik-ut, i datelindjes 11.05.1983 lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, Lagja nr. 18, Rr: Dok. "Miti Vokopola" i identifikuar nga Leternjoftimi nr. 027913305, nr. Personal I30511200B leshuar me date 23.11.2009 dhe date skadimi 22.11.2019.

Bien dakort per sa me poshte vijon:

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar: **“PRESF IN WORLD” SH.P.K.**

Selia e shoqerise caktohet ne Durres, Lagja nr.13, Plazh, Hyrja 1, Ap.45, Pasuria nr. 60/17/ND+1-45, Zona Kadastrale 8518.

1. Emertimi tregtari shoqerise eshte : **“PRESF IN WORLD” SH.P.K.**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje afat kohor te pakufizuar.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

- Hartimi dhe realizimi i projekteve Hardware dhe Software ne nivel kombetar dhe nderkombetar edhe te financuara pjeserisht apo plotesisht nga Komuniteti Europian.
- Menaxhim sherbimesh te sistemeve hardware dhe software.
- Trajnime Profesionale , kurse te formimit profesional , individuale dhe ne grup ne fushen e siper marrjes, si dhe partner ne kujdesin shendetesor, ne fushen profesionale dhe universitare, kurse te gjuhes se huaj (shqip, italisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht, etj).

- Projekta e rrjeti, sisteme te integruara te menaxhimit te proçeseve formuese dhe informuese per internetin, krijimin dhe menaxhimin e faqeve te internetit (Web) dhe portaleve, kurse kompjuterike (kurse formimi baze, art design, finance 5, programim dhe administrim rrjeti.....)
- Realizim dhe menaxhim te sherbimeve dhe strukturave te kujdesit shendetesor, perfshire trajnimin e punonjesve. Ndermjetese ne tregun e punes (Kompani Punesimi).
- Projekte te integruara te energjise se rinovueshme (energji alternative, Diellore, Termodinamike, etj)
- Realizim dhe menaxhim te te dhenave nepermjet sistemit elektronik (Banche Dati), nepermjet instrumentave Hardware dhe software.
- Ushtrimin te çdo veprimtarie te ligjshme, te lejueshme per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohe me ligj sipas nenit 7 te Ligjit tregtar nr.9901, dt.14.04.08.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 [njqind mije] leke, i ndare ne 4 kuota.

Ky kapital perbehet nga kontributet e meposhteme ne para te Ortakeve:

STEFANO SANTI disponon 25 % pjese te kapitalit
PIERO TITO ARGIOLAS disponon 25 % pjese te kapitalit
SHPETIM TROPLINI disponon 25 % pjese te kapitalit
ARIAN DEDEJ disponon 25 % pjese te kapitalit

Shuma e nenshkruar do te depozitohet ne Banke ne afatin dhe kushtet qe percaktohen per kete qellim me vendim te zakonshem te shoqerise.

Administratori emerohet me afat 5 (pese) vjetesh duke filluar nga data e themelimit te kesaj shoqerie pra sot me date 23.10.2018, me te drejte ripertertije.

Administrator i vetem caktohet Z. **ARIAN DEDEJ** .

Administratori gezon kompetencat dhe i ushtron ato ne perputhje me ligjin dhe statutin e shoqerise. Shoqeria ka nje Administrator te vetem. Me vendim te Ortakeve mund te shtohet numri i Administratoreve.

Asambleja e Ortakeve, shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit financiar, miratimi ben automatikisht, sipas modalitetit te vendimartjes , kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te Shoqerise . Viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.


Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne Durres ne tre ekzemplare origjinale duke pasur te gjithë ekzemplaret fuqi te barabarte ligjore.

FIRMOSUR NGA ORTAKET


STEFANO SANTI

STEFANO SANTI


PIERO TITO ARGIOLAS

Argiolas Piero Tito


SHPETIM TROPLINI

Troplini Shpetim


ARIAN DEDEJ

Arian Dedej




STATUTI

“PRESF IN WORLD” SH.P.K.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe Adresa

Neni 1: Data e Themelimit, Emri, Themeluesit dhe Forma

(1) Sot, më 23.10.2018 ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“PRESF IN WORLD” SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

1. Z. STEFANO SANTI, i biri i Franco, i datelindjes 25.06.1953, lindur ne Rome dhe banues ne Rome, Rr.Giacomo, Trevis, Nr.76, SC.UN PI 3 IN.15, Itali, nenshtetas italian, i pajisur me Karte e Identitetit te Republikes se Italise nr. AY 8038168, leshuar me date 18.07.2018 dhe date skadimi 25.06.2029.

2. Z. PIERO TITO ARGIOLAS, i biri i Cesare, i datelindjes 04.12.1965, lindur ne Villasalto (CA) dhe banues ne Rr. Lega S. 10 Latina (LT), Itali, nenshtetas Italian, i pajisur me Karte Identiteti te Republikes se Italise me nr.CA99012BQ, leshuar me date 02.07.2018 dhe date skadimi 04.12.2028.

3. Z.SHPETIM TROPLINI, i biri i Gani-ut, i datelindjes 26.07.1969, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagja 5, Rr.Andon Naci, Pall.636, nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e Republikes Italiane me nr.YA3856554, leshuar me date 12.05.2012 dhe date skadimi 11.05.2022.

4.Z.ARIAN DEDEJ, i biri i Besnik-ut, i datelindjes 11.05.1983 lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, Lagja nr. 18, Rr: Dok. "Miti Vokopola" i identifikuar nga Leternjoftimi nr. 027913305, nr. Personal I30511200B leshuar me date 23.11.2009 dhe date skadimi 22.11.2019.

DATA E THEMELIMIT 23.10.2018

- (3) - Shoqeria eshte person juridik e formes “SH.P.K.”
- Shoqeria eshte person juridik e krijuar ne baze te ligjit shqiptar ne fuqi
 - Aktivitetin ajo do ta zhvilloje sipas ketij Statuti, legjislacionit shqiptar tregtar dhe atij nderkombetar si dhe legjislacionit te pergjithshem te aplikueshem ne fuqi

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Hartimi dhe realizimi i projekteve Hardware dhe Software ne nivel kombetar dhe nderkombetar edhe te financuara pjeserisht apo plotesisht nga Komuniteti European.
- Menaxhim shërbimesh te sistemeve hardware dhe software.
- Trajnime Profesionale , kurse te formimit profesional , individuale dhe ne grup ne fushen e siper marrjes, si dhe partner ne kujdesin shendetesor, ne fushen profesionale dhe universitare, kurse te gjuhes se huaj (shqip, italisht, anglisht, frengjisht, gjermanisht, etj).
- Projekte ne rrjet, sisteme te integruara te menaxhimit te proçeseve formuese dhe informuese per internetin, krijimin dhe menaxhimin e faqeve te internetit (Web) dhe portaleve, kurse kompjuterike (kurse formimi baze, art design, finance 5, programim dhe administrim rrjeti.....)
- Realizim dhe menaxhim te shërbimeve dhe strukturave te kujdesit shendetesor, perfshire trajnimin e punonjesve. Ndermjetese ne tregun e punes (Kompani Punesimi).
- Projekte te integruara te energjise se rinovueshme (energji alternative, Diellore, Termodinamike, etj)
- Realizim dhe menaxhim te te dhenave nepermjet sistemit elektronik (Banche Dati), nepermjet instrumentave Hardware dhe software.
- Ushtrimit te çdo veprimtarie te ligjshme,te lejueshme per formen e shoqerise,e cila nuk ndalohe me ligj sipas nenit 7 te Ligjit tregtar nr.9901,dt.14.04.08.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë :PA LIMIT

Neni 4: Selia, Adresa

Durres, Lagja nr.13, Plazh, Hyrja 1, Ap.45, Pasuria nr. 60/17/ND+1-45, Zona Kadastrale 8518.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 LEKE.**
- (2) Kapitali themeltar eshte eshte i ndare ne 4 kuota

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaket themelues:

STEFANO SANTI

1 kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë

Kontributi:

25%

dhe vlera e kontributit;

25 000 LEKE



PIERO TITO ARGJOLAS

1. kuote e zotërimit të kapitalit të shoqërisë

Kontributi: dhe vlera e kontributit;
25 % **25 000 LEKE**

SHPETIM TROPELINI

1. kuote e zotërimit të kapitalit të shoqërisë

Kontributi: dhe vlera e kontributit;
25 % **25 000 LEKE**

ARIAN DEDEJ

1. kuote e zotërimit të kapitalit të shoqërisë

Kontributi: dhe vlera e kontributit;
25 % **25 000 LEKE**

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

(1) Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpushëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

(3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

(4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarinimin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

(5) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluarat dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

(6) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

(7) Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 7: Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve



Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 8: Kalimi me Kontratë i Kuotave

- (1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.
- (2) Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord me personin të cilit i kalon kuota.
- (3) Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.
- (4) Në çdo rast secili ortak duhet të respektojë të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë në rast se ai dëshiron të shesë kuotat e tij takuese në kapitla të themeltar të shoqërisë.-----

Neni 9: Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- (1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- (3) Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Neni 10: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- (1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- (2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Kreu III

Asambleja e Përgjithshme



Neni 11: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Administratorët thërrasin Asamblesën e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesës së Përgjithshme.
- (2) Mbledhja e Asamblesës së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesës së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë për qind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
- (3) Mbledhjet e Asamblesës së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 12: Mbledhjet e Asamblesës së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorunit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me arritjen e kuorunit me shumice të thjeshte për :
- Vendime në lidhje me shitblerjen e Kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë,
 - Vendime në lidhje me emerimin, shkarkimin dhe ceshtje të tjera në lidhje me Administratorin të Shoqërisë
- (3) Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesës së Përgjithshme.
- (4) Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (5) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (6) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesës së Përgjithshme.
- (7) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesës së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesës së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesës së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- (8) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose



2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortakut.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 13: Votat e Ortakëve

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 14: Votimi me Prokurë

(1) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortakët sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

... **“PRESF IN WORLD” sh.p.k.....**

Une i nënshkruari, _____, në cilësinë e ortakut të shoqërisë së lartpërmendur, nuk emërojmë asnjë person, në cilësinë e përfaqësuesit tonë për të votuar në emrat tonë dhe në llogarinë tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet të pakten një here në vit dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më.....”.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më.....”.

(3) Aktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

(4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 15: Hetimet e posaçme



(1) Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.



Kreu IV Administratorët

Neni 16: Emërimi i Administratorëve

(1) Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

(2) Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: Nr. dhe specimenët e nënshkrimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

4.ZARIAN DEDEJ, i biri i Besnik-ut, i datelindjes 11.05.1983 lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, Lagja nr. 18, Rr: Dok. "Miti Vokopola" i identifikuar nga Leternjoftimi nr. 027913305, nr. Personal I30511200B leshuar me date 23.11.2009 dhe date skadimi 22.11.2019.

(4) Administratori ka një kohezgjatje 5 (pese) vjeçare duke filluar nga data 23.10.2018 me te drejte ripërtëritje.

(5) Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 17: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

(1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje pa aftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 18: Shpërblymi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

(1) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurim ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilat janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve tilla.

(4) Administratorëve mund t'iu paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 19: Mbledhjet e Administratorëve

(1) Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

(2) Vendimet e mbledhjes së Administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga Administratorët, dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë dy.

(3) Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 20: Kufizimet në Votimet e Administratorëve

(1) Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe

2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet regjistrohesh pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



(2) Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe formës së prerë.

Neni 21: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 22: Dividendët

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

(5) Ortakë duke marrë në konsideratë mendimin e administratorit mund të terheqin paradhenie të dividendeve edhe përpara mbylljes së vitit ushtrimor, por duke lënë në shoqëri tatimin mbi këtë paradhenie dividendi.

Neni 23: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet



Neni 24: Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria mund të caktojë në pozicionin e likuidatorit edhe një nga ortakët.

Neni 25: Njoftimet

- (1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- (2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.
- (3) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Kreu VII Dispozita të Fundit

Neni 26: Shndërrimi i shoqërisë

- (1) Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite mund të kryet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve, ndërsa shndërrimi në shoqëri anonime, me miratimin e shumicës së cilësuar të ortakëve të shoqërisë.

Neni 27: Dispozita të tjera.

- (1) Të tëra shpenzimet për investime dhe financiare për nevojat emergjente të ecurisë së shoqërisë duhet të nënshkruhen nga të tërë ortakët e shoqërisë. Në asnjë rast nuk do të njihen shpenzimet e kryera të cilat nuk i janë komunikuar dhe justifikuar me parë të tërë ortakëve të shoqërisë.
- (2) Administratori i shoqërisë ngarkohet të përgatitë bilancë 1 (një) vjeçare për të evidentuar ecurinë e shoqërisë. Këto bilancë do të diskutohen në mbledhje të shoqërisë të cilat janë thirrur enkas për këto analize.
- (3) Ortakët nuk mund të kryejnë asnjë aktivitet tjetër i cili përmban elemente konkurrence me këtë shoqëri, qoftë edhe nëpërmjet personave të tjerë.

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

STEFANO SANTI

STEFANO SANTI

PIERO TITO ARGIOLAS

Piero Tito Argiolas

SHPETIM TROPLINI

Shpetim Troplini

ARIAN DEDEJ

Arian Dedej

Dedej

Republika e Shqiperise
Dhoma e Notereve Durres

Nr. 4226 Rep.

Durres, me 23.10.2018



Vertetim Nenshkrimi

Ne Durres, sot me date 23.10.2018 (dymije e tetembedhjete), ditën e Marte, ne zyren e Noterise te ndodhur ne Lagjen nr.4, Rr."Egnatia", Durres, perpara meje noterës **Rovena Jakova**, Anetare e Dhomes se notereve Durres, u paraqiten personalisht shtetasit e meposhtem:

1. Z. STEFANO SANTL, i biri i Franco, i datelindjes 25.06.1953, lindur ne Rome dhe banues ne Rome, Rr.Giacomo, Trevis, Nr.76, SC.UN PI 3 IN.15, Itali, nenshtetas italian, i pajisur me Karte e Identitetit te Republikës se Italisë nr. AY 8038168, leshuar me date 18.07.2018 dhe date skadimi 25.06.2029.

2. Z. PIERO TITO ARGIOLAS, i biri i Cesare, i datelindjes 04.12.1965, lindur ne Villasalto (CA) dhe banues ne Rr. Lega S. 10 Latina (LT), Itali, nenshtetas Italian, i pajisur me Karte Identiteti te Republikës se Italisë me nr.CA99012BQ, leshuar me date 02.07.2018 dhe date skadimi 04.12.2028.

3. Z.SHPETIM TROPLINI, i biri i Gani-ut, i datelindjes 26.07.1969, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, Lagja 5, Rr.Andon Naci, Pall.636, nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e Republikës Italiane me nr.YA3856554, leshuar me date 12.05.2012 dhe date skadimi 11.05.2022.

4.ZARIAN DEDEL, i biri i Besnik-ut, i datelindjes 11.05.1983 lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, Lagja nr. 18, Rr: Dok. "Miti Vokopola" i identifikuar nga Leternjoftimi nr. 027913305, nr. Personal I30511200B leshuar me date 23.11.2009 dhe date skadimi 22.11.2019.

Madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet me deshire te plote dhe vullnet te lire, nenshkruan personalisht, ne prezencen time:

AKT- THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "PRESF IN WORLD" SHPK, DATE 23.10.2018, redaktuar jashte kesaj zyre noteriale, bashkangjitur ketij vertetimi nenshkrimi.

Une, noterja Rovena Jakova, ne baze te ligjit nr.7829 date 01.06.1994, date 01.06.1994 "Per Noterine", e vertetetoj rregullisht sipas ligjit.



NOTERE

Rovena JAKOVA

Cognome **SANTI**
 Nome **STEFANO**
 nato il **25/06/1953**
 (atto n. **01650** 1 s. **A04**)
 a **ROMA**
 Cittadinanza **ITALIANA**
 Residenza **ROMA**
 Via **VIA GIACOMO TREVIS N.76 SC.UN.PI.3 IN.15**
 Stato civile **CONIUGATO**
 Professione **DIRIGENTE**

CONNOTATI E CONTRASSEGNI SALIENTI

Statura **1,80**
 Capelli **Brizzolati**
 Occhi **Verdi**
 Segni particolari **---**



Firma del titolare *Stefano Santi*
ROMA 18 LUG 2018

IL SINDACO
 Istruttore Amministrativo
Mauro Targa

Impronta del dito indice sinistro



DATA DI SCADENZA
25 GIU 2029

AY 8038168

REPUBBLICA ITALIANA

COMUNE DI
ROMA

CARTA D'IDENTITA'
 N° **AY 8038168**

DI
SANTI
STEFANO

